

135 BURIMET ELEKTRONIKE

Fusha përmban të dhënat e koduara për burimet elektronike.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
135	Burimet elektronike	nr
a	<i>Lloji i burimit elektronik</i>	nr
b	<i>Përcaktimi specifik i materialit</i>	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

135a Lloji i burimit elektronik

Kodi tregon llojin e burimit elektronik.

a	<i>numerik</i> Skedari përmban kryesisht numra ose përfaqësohet me numra, siç janë regjistrimet që përmbajnë të dhëna për notat e studentëve, të dhëna statistikore etj. Të dhënat mund të jenë në formën origjinale ose të mbledhura apo të përpunuara në mënyrë statistikore.
b	<i>program kompjuteri</i> Skedari përmban një grup të caktuar komandash për ekzekutimin e operacioneve bazë si dhe për identifikimin e të dhënave të nevojshme dhe procedurave. Në këtë kategori përfshihen edhe programet për videolojëra si dhe modelet kompjuterike.
c	<i>grafikë</i> Skedari përmban të dhëna grafike dhe të pikturuara, të cilat mund të përpunohen së bashku me skedarët e llojit tjetër, duke përpunuar shfaqjet grafike për prezantimin e të dhënave.
d	<i>tekst</i> Skedari përmban të dhëna kryesisht alfabetike (fjalë ose fjali) të konvertuara në formën e lexueshme nga makina (kompjuteri) për përpunim të mëtutjeshëm kompjuterik, klasifikim, redaktim dhe kërkim në forma të ndryshme. Këtu hyjnë skedarët që përmbajnë tekste letrare. Në regjistrimet e krijuara para përdorimit të kodit "e", kodi "d" është përdorur edhe për skedarët bibliografik.
e	<i>të dhëna bibliografike</i> Burimin e ndërtojnë të dhënat me referenca bibliografike. Këtu bëjnë pjesë të dhënat nga katalogët e bibliotekave ose bazat e të dhënave me citate. Të dhënat mund të jenë në formë të strukturuar ose të pastrukturuar.
f	<i>fonti/shkrimi</i>

	Burimi përmban të dhëna, me ndihmën e të cilave (nga të cilat) kompjuteri mund të prodhoj lloje të ndryshme shkrimesh.
g	<i>lojë</i> Burimi është lojë e krijuar për argëtim ose edukim. Zakonisht përbëhet nga teksti dhe programi. Në këtë kategori hynë videolojërat.
h	<i>tingull</i> Burimi përmban të dhëna të koduara që ndihmojnë kompjuterin për të prodhuar tingull.
i	<i>multimedia ndërvepruese</i> Burimi i përshkruar mundëson lundrimin në lloje të ndryshme të regjistrimeve dhe i vendos ato në një shfaqje (p.sh. zë, fotografi etj.).
j	<i>sistem ose shërbim online</i> Burimi i përshkruar është sistem ose shërbim online dhe mund të përmbajë të dhëna që nuk janë bibliografike. Sistemi ose shërbimi online mundëson bashkëveprimin midis përdoruesit dhe sistemit. P.sh.: sisteme bibliotekare online, shërbime FTP, sisteme komunikimi të drejtpërdrejta përmes kompjuterit, grupe diskutimesh, faqe interneti, qendra informacioni në rrjet.
u	<i>nuk dihet</i> Lloji i skedarit nuk dihet.
v	<i>kombinim</i> Skedar me lloje të ndryshme të të dhënave.
z	<i>tjetër</i> Lloji i skedarit për të cilin nuk ekziston kodi përkatës.

135b Përcaktimi specifik i materialit

Kodi tregon llojin e bartësit të të dhënave.

a	<i>shirit (1600 bpi)</i>
b	<i>shirit (6250 bpi)</i>
c	<i>QIC2 (kasetë për PC)</i>
d	<i>kasetë DAT</i>
e	<i>kasetë audio e zakonshme</i> Formate të ndryshme të regjistrimit për kompjutera të ndryshëm.
f	<i>disketë (3.5 in.)</i>
g	<i>disketë (5.25 in.)</i>
h	<i>CD-ROM</i>
i	<i>online</i>
j	<i>DVD</i>
k	<i>USB</i>
z	<i>tjetër</i>

SHEMBUJ

1.

135	□□	ad bi <i>(Skedar online me tekst.)</i>
-----	----	--

2.

135	□□	ac bi <i>(Institucioni merret me skanimin e fotografive të zogjëve. Fotografitë janë të disponueshëm online.)</i>
-----	----	---

3.

135	□□	ad <i>(Libra të digjitalizuara që përmbajnë vetëm tekst.)</i>
-----	----	---

4.

135	□□	ah bi <i>(Skedar online në formatin MPEG3 që ka vetëm tingull.)</i>
-----	----	---

5. *

135	□□	av bh <i>(CD-ROM, në të cilin janë ruajtur lloje të ndryshme të skedarëve.)</i>
-----	----	---